

Miqesore/ Shqiperi U19 – Mali i Zi U19 5-1

nga AlbaniaSoccer
E martë, 15 Tetor 2013 22:49



Djelmoshat e Foto Strakoshes kane zhvilluar nje ndeshje miqesore testuese te marten ne Tirane ne stadiumin Selman Stermasi. Perfaqesuesja e Shqiperise se 19-vjecareve ka mundur moshataret nga Mali i Zi me nje goleade 5-1. Ne pjesen e pare kuqezinjte e Strakoshes kane luajtur mjaft mire duke zoteruar pjesen me te madhe te fushes. Megjithate ne sekondat e fundit malazezet kane shenuar golin e avantazhit. Ne pjesen e dyte ka ardhur permbyjsja e madhe. Cekici ka shenuar dy gola e pas tij Gjini, Hoxha dhe Kraja. Ne fund Strakosha eshte shprehur i kenaqur nga loja dhe rezultati, nderkohe qe takimi i dyte miqesor po me Malin e Zi do te luhet me date 17 tetor ne stadiumin Kombetar Qemal Stafa.